



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 124/14 prot.

Tiranë, më 17.07.2019

VENDIM

Nr. 84, datë 17.07.2019

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 44, DATË 07.05.2019**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 44, datë 07.05.2019, “Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit *****”,

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet informacionit me nr. 124/2 prot., datë 12.02.2019, nëpunësi ***** , ka parashtruar përpara Komisionerit disa pretendime për parregullsi lidhur me dhënien e masës disiplinore “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri 3 (tre) muaj, për mospërbushje të detyrave”, dhënë nga Komisioni i Disiplinës, ngritur në institucionin Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Për të sqaruar rrethanat e rastit, Komisioneri, me shkresën nr. 124/2 prot., datë 12.02.2019, ka nisur fillimin e verifikimit të këtij informacioni. Në përfundim të hetimit administrativ procesi është përmyllur me Vendimin Nr. 44, datë 07.05.2019, “Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit *****”, në të cilin është vendosur:

“1. Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, të drejtojë procesin administrativ në përmbajtje të të cilit, Komisioni i Disiplinës, në bazë të pikës 1, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të anulojë Vendimin nr. 19, datë 29.01.2019, për dhënien e masës disiplinore, “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri 3 (tre) muaj”, nëpunësit *****”.

2. Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, të kujdeset për heqjen nga dosja e personelit të nëpunësit ***** , të aktit të mësipërm të dhënies së masës disiplinore dhe të fshihen shënimet e bëra në dosje.

Në vijim, Agjencia Kombëtare e Mjedisit me shkresën nr. 950/4 Prot., datë 17.05.2019, me objekt: “Kthim përgjigje”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 124/12 Prot., datë 22.05.2019, ka vënë në dijeni këtë të fundit se:

“Nëpunësi civil *****, ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, kërkesë padi, me objekt: “Shfuqizimin e vendimit nr. 19, datë 29.01.2019, të Komisionit të AKM-së në lidhje me marrjen e masës disiplinore “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë 3 (tre) muajore për nëpunësin civil *****, Specialist i Lejeve Mjedisore dhe VNM Tiranë”.

Në këto kushte, kur çështja nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, po shqyrtohet në seancë gjyqësore, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, nuk mund të procedohet me ekzekutimin e vendimit të Komisionerit për Shërbimin Civil, pa përfunduar procesi gjyqësor”.

Në analizë të praktikës shkresore të këtij rasti, vërej se:

Referuar nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon se: “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata”, çmoj se zbatimi i këtij vendimi nuk mund të ndiqet më tej nga ana e Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 44, datë 07.05.2019, “Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit *****”.
2. Për këtë vendim të njoftohet Departamenti i Administratës Publike, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe nëpunësi *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha